



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt. 21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt.20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" të Statutit të Komunës së Prishtinës 01nr.110-391 dt.25.02.2010, dhe bazuar në kërkesën 05nr.070/01 – 14337/26 dt.27.01.2025, të Subjektit juridik "Prishtina NSH"sh.p.k. nga Vushtrria, me certifikatë të biznesit ARBK 812085208, dhe me përfaqësues ligjor Fidan Hasani nga Vushtrria, për pezullimin e kërkesës 05nr.350/02-161364/25 dt.22.10.2025 (sipas eLeja KKN-642), të kërkuarës: Pronarit & Investitorit "Prishtina NSH"sh.p.k. nga Vushtrria, me certifikatë të biznesit ARBK 812085208, dhe me përfaqësues ligjor Fidan Hasani nga Vushtrria, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë ekonomike & industriale – **Ndërtesa "1"** me B+P+1+Nk, në kuadër të Parcelës ndërtimore të Blloku urban "ZIm-07", të Tërësisë urbane "ZIm", të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" dhe Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të vendosjes së çështjes administrative, me datë 02.02.2026, merr këtë:

V E N D I M

**PEZULLIMI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË KËRKESËS 05NR.350/02-161364/25 DT.22.10.2025,
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE PËR NDËRTESE EKONOMIKE& INDUSTRIALE
– NDËRTESA "1" ME B+P+1+Nk,**

I. Pezullohet procedura e vendosjes së çështjes administrative të kërkesës për kushte ndërtimore, 05nr.350/02-161364/25 dt.22.10.2025 (sipas eLeja KKN-642), të kërkuarës: Pronarit & Investitorit, "Prishtina NSH"sh.p.k. nga Vushtrria, me certifikatë të biznesit ARBK 812085208, dhe me përfaqësues ligjor Fidan Hasani nga Vushtrria, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë ekonomike & industriale – **Ndërtesa "1"** me B+P+1+Nk, në kuadër të Parcelës ndërtimore të Blloku urban "ZIm-07", të Tërësisë urbane "ZIm", të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale **nr.10075-2 ZK** Prishtinë, sipas projekt propozimit dhe planit të situacionit - "zgjidhja urbane" të prezantuar, bazuar në kërkesën për pezullim 05nr.070/01 – 14337/26 dt.27.01.2025, të parashtruar nga i njëjti subjekt juridik.

II. Pezullimi i procedurës së vendosjes së çështjes administrative nga paragrafi I. i këtij vendimi, do të zgjasë deri në eliminimin e rrethanave që kanë qar në marrjen e këtij vendimi, përkatësisht deri në arritjen e marrëveshjes me pronarët e parcelave kadastrale të përfshira në kuadër të parcelave ndërtimore të Blloku urban "ZIm-07", të Tërësisë urbane "ZIm", të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë, për një zgjidhje urbane gjithë përfshirëse.

A r s y e t i m

Kërkuarësi: Subjekti juridik "Prishtina NSH"sh.p.k. nga Vushtrria, me certifikatë të biznesit ARBK 812085208, dhe me përfaqësues ligjor Fidan Hasani nga Vushtrria, me kërkesën 05nr.350/02-161364/25 dt.22.10.2025 (sipas eLeja KKN-642), ka kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë ekonomike & industriale – **Ndërtesa "1"** me B+P+1+Nk, në lokacionin e përshkruar si në paragrafin I. të këtij vendimi.

Në fazën e trajtimit të kërkesës së lartcekur, aplikuesi i lartcekur, në kërkesën 05nr.070/01 – 14337/26 dt.27.01.2025, ka kërkuar nga kjo drejtori, pezullimin e procedurës administrative, deri në arritjen e marrëveshjes së përbashkët, edhe me pronarët tjerë të pronave të përfshira në kuadër të parcelave ndërtimore të, Blloku urban "ZIm-07", të Tërësisë urbane "ZIm", të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë, për një zgjidhje urbane gjithë përfshirëse.

Andaj, Drejtoria e Urbanizimit dhe Mjedisit, bazuar në konstatimet e lartcekura dhe duke u mbështet në rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht në nenin 85 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, vendosi që, deri në eliminimin e rrethanave që kanë qar në pezullimin e procedurës së çështjes administrative, përkatësisht deri në arritjen e marrëveshjes me pronarët e parcelave kadastrale, të përfshira në kuadër të parcelave ndërtimore të Blloku urban "ZIm-07", të Tërësisë urbane "ZIm", të Planit Rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë, për përfshirje në propozim "zgjidhja urbane", të prezantuar, dhe më pas, vazhdimin e procedurës për caktimin e kushteve ndërtimore, sipas kërkesës 05nr.350/02-161364/25 dt.22.10.2025 (sipas eLeja KKN-642), ta pezullojë me këtë vendim.

Bazuar në konstatimin e lartcekur, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet, apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuesit/investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosjen e lëndës, 05nr.350/02-161364/25 dt.22.10.2025 (sipas eLeja KKN-642) & 05nr.070/01 – 14337/26 dt.27.01.2026.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 –161364/25 DT.02.02.2026,

Zyrtari:
Ergyn Hajredini,



Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi.